



www.lezha.gov.al

bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, i përmuajshëm, Nr. 1. Maj 2017



Pashkët më të veçanta në Shqipëri



Investimet në infrastrukturë, fq 9




Koha për të kulluar tokat, fq 14



Ambasadorët interes për Lezhën, fq 16



Rrugëtimi i bibliotekës, fq 24



përmbajtja

Buxheti Afatmesëm i Bashkisë	4
Trajnime për një qeverisje më të mirë	6
Ambasada zvicerane çmim për Bashkinë	7
Z1N, transparencë dhe informim	8
Investimet e Bashkisë në infrastrukturë	9
Nisin përgatitjet për sezonin turistik	12
Trajtimi i qenve të rrugës, prioritet	13
Koha për të kulluar tokat	14
Ambasadorët, interes për Lezhën	18
Shkëmbim eksperiencash me bletërritësit italianë	16
Vizitë studimore në komunën Otmuchow, Poloni	17
Panairi i turizmit mesdhetar	20
Festa e Pashkëve në Lezhë	21
Lezha mirëpret Arbëreshët	22
Konkursi i ideve më të mira të biznesit	23
Rrugëtimi i Bibliotekës ...	24
Folklori i Lezhës mirëpritet në Itali	27
IP Robot fiton kupën e Shkollave Profesionale	28
Kampionati i peshkimit sportiv në Tale	29
Njoftime	31

Redaksia

Drejtoria e Integritimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit
 Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri
 Fotot: Olsi Tetaj
 Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj
 Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al

Buxheti Afatmesëm i Bashkisë për vitet 2017-2019

Mbas reformës territoriale Bashkia operon në një territor më të gjërë, pra vendosja e një ekuilibri eficient dhe të qëndrueshëm mes tyre kërkoi një vizion të qartë të bazuar në njohje kapilare të territorit dhe me mbështetje e kontribut aktiv e të vazhdueshëm nga institucionet vendore, qytetarët, bizneset, shoqëria civile, planifikuesit, etj.

Është pikërisht Strategjia e Ardhsme e Zhvillimit të territorit të Lezhës, e cila tashmë në përfundim, që shihet si lexim dhe mirëkuptim i kësaj shumëllojshmërie. Ky dokument i integruar dhe dokumentat e tjera strategjike, i kane shërbyer edhe procesit të planifikimit të integruar të PBA 2017-2019 dhe buxhetit të vitit 2017. Pra, Bashkia Lezhë, në procesin e planifikimit dhe përfitimeve të komunitetit, nuk shikohet si një bashkësi prej dhjetë njësisish administrative, por si një organizëm i vetëm ku çdo zonë ose grup popullate ka të njëjtat raporte me territorin dhe me administratën vendore.

Vizioni i Bashkisë Lezhë synon të bëhet:

(i) platformë shkëmbimi dhe e kompletuar me logjistike

mbështetëse për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, energjisë dhe personave,

(ii) qendër zhvillimi ekonomik tërheqëse për investimet e huaja.

(iii) qendër urbane policentrike e pjesshme që ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve të saj, dhe të vizitorëve.

Politikat Strategjike;

- Politika Strategjike 1: Lezha, platformë shkëmbimesh & nyje logjistike në shërbim të rajonit të Ballkanit dhe Europës Jug-Lindore.

- Politika Strategjike 2: Lezha atraktive për investitorët strategjikë & motor zhvillimi ekonomik në Shqipëri.

- Politika Strategjike 3: Lezha për qytetarët. Bashkia Lezhë do të ofrojë shërbime efçente, cilësore dhe gjithëpërfshirëse të fokusuara tek banorët.

Bazuar në këtë kuadër planifikimi, shpërndarja e burimeve është adresuar drejt politikave dhe qëllimeve të zhvillimit strategjik, të cilat orientojnë ;

- Ndërtimin e një strukturë urbane optimale që merr parasysh vendndodhjen dhe zhvillimin e poleve urbane, denësitetin e sipërfaqes së ndërtuar, sipërfaqeve të hapura & jeshile, dhe sistemet e transportit, etj;

Tabela tregon fondet për çdo program sipas viteve 2017-2019 në mijë/lekë


Programet buxhetore	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
P1 Planifikim Manaxhim Administrim	366,760	362,411	362,411
P2. Shërbimet publike	275,587	175,179	175,679
P3. Infrastruktura rrugore dhe transporti publik	248,043	290,285	321,339
P4. Arsimi parashkollor & parauniversitar	248,143	244,037	248,907
P.5 Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit	0	3,000	3,000
P.6 Strehimi dhe Shërbimet sociale	28,333	28,000	28,000
P.7 Kultura, Sportet, Turizmi dhe Rinia	84,507	45,395	46,303
P.8 Mbrojtja dhe siguria publike	63,936	65,246	66,521
P.9 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	16,908	16,974	17,474
P.10 Bujqësia dhe zhvillimi rural	68,418	35,025	35,726
Fondi rezervë	5,000	5,000	5,000
Fondi i Kontigjencës	5,000	5,000	5,000
TOTAL I SHPENZIMEVE	1.410.635	1,275,555	1,315,360

- Përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe barazisë sociale për banorët e saj të ndërtuar në gamën e shërbimeve dhe të mirave materiale që i ofron ambienti urban qytetarëve si dhe aksesit të qytetarëve në to. Këtu mund të përmendim punësimin, shëndetin, arsimimin, kulturën, mbrojtjen sociale, dhe shërbimet e tjera për qytetarët, dhe vizitorët e qytetit.


Bashkia Lezhë përbëhet nga 10 njësi administrative (ish-Bashkia Lezhë dhe 9 Komunat). Ka dy qytete (Lezha dhe Shëngjini) dhe 65 fshatra. Ajo gjendet në veriperëndim të vendit dhe kufizohet në veri me Bashkitë Shkodër e Vau-Dejës, në lindje me Bashkinë Mirditë, në jug me Bashkinë Kurbini dhe në përendim me detin Adriatik. Ka një sipërfaqe prej 456.8 km², ku rreth 65 % e saj është kodrinore e malore dhe 35 % e sipërfaqes është fushore. Popullsia sipas gjendjes civile është 108,519 banorë, ndërsa sipas Census-it është 65,633 banorë. Në qendrat urbane jetojnë rreth 40 % e popullsisë, ndërsa rreth 60% e popullsisë jetojnë në zonën rurale. Degët bazë të ekonomisë së saj janë bujqësia, turizmi dhe tregëtia. Në territorin e Bashkisë zhvillojnë aktivitetet pothuajse të gjitha llojet e transportit, si ai rrugor, hekurudhor dhe detar. Në këtë territor është Porti Detar i Shëngjinit dhe Aeroporti Ushtarak i Gjadrit.

Bujqësia dhe Turizmi janë sektorët më prioritar të zhvillimit, krahas sektorëve të tjerë si peshkimi, industria e përpunimit të drurit, materialeve të ndërtimit, tregëtisë dhe të shërbimeve. Turizmi, krahas bujqësisë është një nga sektorët më në rritje e zhvillim, kryesisht ai bregdetar, i cili zhvillohet në një vijë bregdetare prej 38 km. Krahas këtij turizmi një burim asetesh turistik janë edhe trashëgimia arkeologjike, etno-kulturore, historike dhe burimet e tjera natyrore dhe të traditës.

Bashkia Lezhë	Qytetet dhe Fshtrat
Nj.A Lezhë	Qyteti: Lezhë
Nj.A Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Fshatra: Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhe, Mali-Rencit, Mali-Shëngjin, Kodër Mulliri.
Nj.A Zejmen	Fshatra: Zejmen, Tresh, Pruell, Bërzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten.
Nj.A Shënkoll	Fshatra: Shenkoll, Tale 1, Tale 2, Barbulloje, Gryke-Lumi, Gajush, Alk, Rrile.
Nj.A Balldre	Fshatra: Balldre i Vjetër, Mali-Kakarrq, Qëndër-Kakarrq, Balldren i Ri, Gocaj, Torovicë, Malecaj, Koljakaj.
Nj.A Kallmet	Fshatra: Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë, Mërq.
Nj.A Blinisht	Fshatra: Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajen, Piraj, Baqel, Kodhel.
Nj.A Dajç	Fshatra: Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragushë, Kotërr, Zojs.
Nj.A Ungrej	Fshatra: Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Rras i Butë, Sukaxhi, Fregen, Zimaj, Kaluer,
Nj.A Kolsh	Fshatra: Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm-Lukaj, Manati, Vele, Grykë-Manati, Barbullojë e Re
TOTALI	2 Qytete dhe 65 Fshatra



Në Bashkinë Lezhë, transparencja dhe informimi prioritet



Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë dhe Fondacionin Shoqëria e hapur për Shqipërinë, organizuan në Lezhë një takim në shkallë Qarku, ku u diskutua rreth të drejtës së njohjes me informacionin publik. Komisioneri për të drejtën e informimit Besnik Dervishi, theksoi se Bashkia Lezhë është ndër bashkitë më aktive për sa i përket të drejtës së informimit. Është një përvojë e mirë kjo, që duhet perfeksionuar më tej si modeli i duhur në të drejtën e informimit publik.

Ndërsa kryetari i Bashkisë Lezhë zoti Fran Frrokaj solli para të pranishmëve këtë praktikë transparente e korrekte të institucionit që ka të bëjë

me respektimin e ligjit dhe të drejtën e informimit publik. Në një sondazh të bërë, Bashkia Lezhë, theksoi Frrokaj, ka dalë një nga Bashkitë më transparente qoftë me publikun, mediat dhe instancat shtetërore. Pushteti duhet të jetë i ligjit dhe çdo punonjës i administratës duhet të jetë korrekt me ligjin. Ende kemi shumë punë për të bërë, përfundoi fjalën e tij Frrokaj por, kjo frymë është futur në Bashkinë e Lezhës me synim për të ruajtur një vazhdimësi e transparencë në respektimin e ligjit, duke përmbushur me sukses të gjitha detyrimet që rrjedhin prej tij, sidomos mbrojtjen e të drejtës që gëzon çdo qytetar për t'u informuar. Prefekti i Lezhës zoti Eduart Ndreca evidentoi faktin se askush nga au-

toritetet lokale nuk mund të shkelë ligjin mbi të drejtën e informimit. Çdonjëri prej nesh duhet të kuptojë se institucionet janë krijuar në radhë të parë për t'ju shërbyer qytetarëve. Drejtoresha për të drejtën e informimit Ardita Shehaj theksoi në fjalën e saj se çdo qytetar ka të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë arsyet e kërkimit të informacionit. Njohja me informacionin bëhet përmes dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Siç u tha në takim, ligji parashikon përgjegjësi direkte ndaj zyrtarëve që refuzojnë të japin informacionin e kërkuar.


Qeverisja vendore, ambasada zvicerane çmim për bashkinë e Lezhës

Shtatë bashki kanë fituar çmime për praktika të mira në qeverisjen vendore në kuadrin e nxitjes që Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ambasada e Zvicrës i japin bashkive të reja pas Strategjisë së Decentralizimit dhe Reformës Administrative Territoriale. Bashkitë fituese u shpallën në një ceremoni të veçantë të mbajtur në Hotel Sheraton në Tiranë. Katër çmime, secili nga 10,000 franga zvicerane ju dhanë bashkive Lezhë, Roskovec, Vau i Dejës e Tiranë për nisma të vlerësuara në nivel kombëtar. Ndërsa katër çmime prej 5,000 franga zvicerane u fituan nga bashkitë Shkodër, Tiranë, Skrapar dhe Fier të përzgjedhura si praktikë më të mira në nivel rajonal. Praktikë fituese përfshinin shërbime të përmirësuara turizmi, zyra me një ndalesë (Z1N), qendra për qytetarë me aftësi të kufizuara, si

dhe informim e komunikim për qytetarët. “Me pjesëmarrjen tuaj në këtë konkurs ju keni treguar zell dhe vullnet për të paraqitur shembuj nga puna dhe përpjekjet tuaja”, u tha Ambasadori zviceran Christoph Graf kryebashkiakëve dhe stafeve të bashkive përmes një mesazhi në video. “Vazhdoni të përmirësoni qeverisjen vendore, e cila është shtylla kurrizore e demokracisë”, përfundoi mesazhin e tij Ambasadori Graf.

Në këtë aktivitet u prezantua edhe raporti i monitorimit të procesit të decentralizimit – një punë e kryer nga Programi zviceran për Decentralizim e Zhvillim Vendor (DLDP). Raporti tregon mbi ecurinë e decentralizimit dhe përshkruan nivelin e arritjeve apo të sfidave që bashkitë e reja kanë në këtë proces. Konkursi Kombëtar i Praktikave të Mira nga qeverisja

vendore kishte qëllim pikërisht identifikimin e përpjekjeve të bashkive për t'u përgjigjur sfidave që kanë dalë nga zbatimi i reformave, dhe shpërblimin e disa prej nismave më të mira prej këtyre bashkive. Konkursi u organizua nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Programi për Decentralizim e Zhvillim Vendor (DLDP), që zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation dhe financohet nga qeveria Zvicerane. Programi DLDP, prej thuhet një dekadë punon me njësitë e qeverisjes vendore në veri të Shqipërisë, duke dhënë mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të NJQV-ve dhe financimin e projekteve vendore. DLDP gjithashtu ka dhënë mbështetje edhe për një sërë reformash kombëtare dhe hartimin e politikave dhe kuadrin ligjor që ndikon në qeverisjen vendore në Shqipëri.



Krijohet Forumi i Administratorëve



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman Hanns Siedel organizoi në Lezhë një forum diskutimesh me administratorët e Njësive Administrative dhe drejtues të nivelit të dytë të Bashkive në rajonin e Veriut. Qëllimi i këtij forumi është ngritja e Forumit të Administratorëve si pjesë e Shoqatës dhe rritja e kapaciteteve ndërvepruese, komunikuese dhe njohurive në disa prej aspekteve kyçe të pushtetit vendor.

Paketa e trajnimit fokusohet ndër të tjera në këto çështje: Ligji Organik, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë-Bashkia dhe Njësia Administrative; Organizimi i punës dhe komunikimi mes njësive administrative dhe drejtorive të Bashkive; Të drejtat e njeriut dhe roli i Njësive Administrative-Shërbimet Administrative; Aspekte nga Kodi i Procedurës Administrative. Në fund Administratorët bënë zgjedhjen e Administratorëve si anëtarë të Forumit.

Buxhetimi me pjesëmarrje



Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje, si pjesë e nismës “LëvizAlbania”, organizoi trajnimin dy ditor: “Buxheti i Qytetarit-Transparencë në rritje dhe pjesëmarrje aktive në Bashkinë e Lezhës”. Qëllimi i këtij trajnimi kishte të bënte me forcimin e demokracisë vendore dhe përmirësimin e mirëqeverisjes përmes angazhimit të aktorëve të medias. Zv. Kryetarja e Bashkisë Alfrida Dedjonaj-Marku u ndal tek rëndësia që ka diskutimi i buxhetit me qytetarët, vjelja e mendimeve dhe sugjerimeve të tyre për ta bërë kështu më transparente shpërndarjen e investimeve dhe qeverisjen vendore. Ndërsa Prof. Dr. Arben Malaj vuri theksin tek angazhimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit në të gjitha fazat e hartimit të një buxheti. Ndaj, nënvizoi ai, duhet të bejmë maksimumin që të njihen shqetësimet e komunitetit në fushën e arsimit, shëndetësisë, shërbimeve publike dhe infrastrukturës për të krijuar një model të mirë bashkëpunimi mes komunitetit dhe të zgjedhurve të tyre, për të rritur kështu transparencën e parave publike dhe çdo burimi potencial. Nga të pranishmit, gjatë trajnimit u bënë pyetje e diskutime në formën e një bashkëbisedimi të lirë.

Investimet e bashkisë në infrastrukturë




Rruga që lidh superstradën Lezhë-Shkodër me fshatin Gjadër, prej vitesh ishte kthyer në makthin e banorëve të zonës, por edhe të udhëtarëve të tjerë. Ky shqetësim mori zgjidhjen përfundimtare falë investimit të Bashkisë Lezhë, e cila financoi shtrimin e kësaj rruge kryesore. Banorët thonë se me punën e kryer zona merr një tjetër rëndësi edhe në aspektin bujqësor dhe blegtoral. Segmenti rrugor krahas asfaltimit është shoqëruar më pas edhe me plotësimin e sinjalistikës, duke ndërhyrë në vijëzimin apo komponentëve të tjerë. Paralelisht me shtrimin e rrugës, Bashkia Lezhë ka zgjidhur edhe një shqetësim për të cilin prej vitesh nuk ishte gjetur zgjidhje, ndërtimin e varrezave të reja, pasi më parë fshati Gjadër nuk kishte varreza. Tashmë banorët kanë varrezat në qender të zonës ku është bërë edhe sistemimi i tokës dhe rrethimi i saj. Investimi i Bashkisë Lezhë për këto dy vepra publike ishte parashikuar që herët, ndërsa realizimi ishte, sa një detyrim aq edhe dosomoshmëri. Kryetari i Bashkisë Lezhë Fran Frrokaj, në fushatën elektorale të tij të vitit 2015 e kishte cilësuar si parësore zgjidhjen e këtyre dy problematikave, ndërtimin e varrezave të reja dhe shtrimin e rrugës.

Më shumë se tre mijë banorë të fshatit Barbullojë në Njësine Administrative të Kolshit, kanë një tjetër infrastrukturë rrugore. Bëhet fjalë për shtrimin e rrugës së kësaj zone e cila ishte kthyer në një pengesë për jetën e komunitetit, duke ndikuar negativisht në të gjitha fushat e jetës. Bashkia Lezhë investoi rreth 30 milion lekë të reja për rikonstruksionin e plotë të rrugës që përshkon këtë zonë. Kryetari I Bashkisë z.Fran Frrokaj thotë se investimi do të ndikojë dukshëm në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë. Rruga e re që u ndertua në harkun kohor të tre muajve përshkon thajse të gjithë zonen e banuar të Barbullojes, që tashmë do të levizin nëpërmjet një rruge tërësisht të re, rrugë për të cilën premtimi ishte dhënë nga Frrokaj në shpallje të platformës së tij elektorale për zhvillimin e fshatrave.



Rrjetat e kabllave në qytet hiqen së shpejti



Përballë shqetësimeve të shumta të qytetarëve dhe bizneseve për problematikën dhe panoramën e shëmtuar që kanë sjellë kabllot në qytet, Bashkia Lezhë po merr masa për të ndryshuar këtë situatë të trashëguar në vite. Kështu, qindra fije të infrastrukturës së rrjeteve kabllore dhe atyre me fibra optike të komunikimeve elektronike janë shtrirë vend e pa vend në rrugët, sheshet e qendrat e banimit në Lezhë, të cilat veç stonaturës estetike, përbëjnë dhe rrezik për qytetarët. Një merimangë e tërë rrjetesh kabllore është varur në shtylla elektrike e transmetues të tjerë të papërshtatshëm. Për t'i dhënë fund këtij çrregullimi tejet të rënduar zëvendëskryetari i Bashkisë Lezhë, Enver Hafizi thirri në një takim gjithë operatorët kabllor. Atyre ju la afat një javor që të sjellin plan-projektet e tyre, dhe në koordinim me Bashkinë Lezhë të nisin menjëherë nga puna, me qëllim që gjithë këta kabllot të shtrirë pa kriter dhe duke rrezikuar gjithashtu edhe jeten e qytetarëve, të sistemohen në kabllot nëntokësor.

Me gjetjen e këtij akordi, Bashki-operator, kjo situatë e rënduar në Lezhë shumë shpejt do të marrë fund. Kabllot nuk do të kryqëzohen më në ajër si rrjetë merimange, apo të varen në shtylla elektrike të çdo tensioni, me kalime në mënyrë jo estetike dhe të papranueshme në mjedis publike si; fasada objektivësh, taraca, rrugë, banesa, lulishte dhe sheshe të qytetit.

Protesta e banorëve të Torovicës për rrugën



Protestës së banorëve të Torovicës për shtrimin e rrugës që është tërësisht e amortizuar iu bashkua edhe Kryetari i Bashkisë Fran Frrokaj, i cili deklaroi se projektin për shtrimin e rrugës Bashkia e ka paraqitur disa herë për financim në Qeveri dhe institucione të tjera. Pasi shprehu të gjithë mbështetjen për kërkesat e tyre, Frrokaj ju premtoi banorëve se do të jetë më ta edhe ditën e nesërme në protestën e cila ka për qëllim devijimin e rrugës Balldre-Shkodër, në kahun tjetër nga Torovica, si mënyrë që qeveritarët të njihen me realitetin e hidhur të asaj rruge dhe të jetës së tyre.

Nga ana tjetër edhe Prefekti i Lezhës, Eduard Ndreca tha se do ta përcillte zërin e banorëve në institucionet qeveritare dhe se kësaj proteste do t'i bashkohet edhe ai vetë. Dhe kështu ndodhi vërtetë. Kryetari i Bashkisë Lezhë z. Fran Frrokaj ju bashkua protestës së banorëve të Torovicës edhe në ditën e dytë ku për disa minuta bllokuan rrugën Balldre-Shkoder. Trafiku u devijua në rrugën e shkatërruar të Torovicës ndërsa kryebashkiaku Frrokaj tha se kjo protestë ka si qëllim thirrjen ndaj qeverisë për të ndërhyrë pasi projekti është dërguar për financim disa herë. Prefekti i Lezhës z. Eduard Ndreca i cili ishte në këtë protestë u shpreh optimist për ndërtimin e këtij segmenti rrugor.

Nxënësit për riciklimin e mbetjeve urbane

Instituti i Kërkimeve Urbane, është duke zbatuar së fundmi, projektin: “Vlerësimi i Mangësive në Zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve”, i cili është bërë i mundur me mbështetjen financiare të REC Albania nëpërmjet fondeve të Bashkimit Evropian. Në kuadër të këtij projekti, Instituti i Kërkimeve Urbane në bashkëpunim me Bashkinë e Lezhës ka organizuar një sfidë inovative me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave 9-vjeçare “Gjergj Kastriotit”, “Besëlidhja”, “Nënë Tereza” dhe “Gjergj Fishta” të qytetit të Lezhës. Ky aktivitet inovativ kishte për qëllim kryesor rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve në drejtim të riciklimin të mbetjeve urbane. Drejtori i projektit Edlir Vokopola vuri në dukje rëndësinë e këtij konkursi që ka të bëjë me zhvillimin e fantazisë së nxënësve në ripërdorimin e mbetjeve që hidhen dhe ndarjen e tyre që në burim. Ndërsa zëvendëskryetarja e bashkisë Alfrida Dedgjonaj-Marku dhe drejtori i Programit Zhvillimit Petrit Marku vunë në dukje përpjekjet që po bën bashkia për një Lezhë të pastër. Ky projekt, theksuan ata, do të ndihmojë në realizimin e

politikave strategjike të menaxhimit të mbetjeve, në qytet dhe gjithë njësitë e tjera administrative. Më pas nxënësit u përfshinë në garën konkurruese të përgatitjes së objekteve artistike, të krijuara nga materiale të zhvlerësuar (mbetje të riciklueshme) duke i ripërdorur ato dhe rritur atyre jetëgjatësinë. Në këtë konkurs të sfidës inovative të nxënësve, juria dha dhe vlerësimet për grupet konkurente të shkollave. Për punimet me të arrira me çmim të parë u vlerësuan nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Fishta”. Kjo sfidë inovative kishte të bënte me ndërgjegjësimin, stimulimin e fantazisë dhe kreativitetit të nxënësve në lidhje me riciklimin e menaxhimin më të mirë të mbetjeve urbane. Projekti ka si qëllim të përmiresojë bashkëpunimin mes OSHC-ve mjedisore dhe autoriteteve shtetërore, pjesëmarrjen aktive dhe cilësore në proceset legjislative si dhe të mbajë një rol aktiv në monitorimin e zbatimit të legjislacionit duke patur parasysh nismat publike dhe ato private. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe realizohet me mbështetjen e REC Shqipëri në kuadër të Projektit ACHIEVE.



Stabilizohet situata e mbetjeve urbane



Situata e rënduar nga mbetjet urbane në qytetin e Lezhës dhe zonën bregdetare të Shëngjinit, tashmë ka marrë fund. Problemi është zgjidhur përfundimisht pasi menjëherë pas lidhjes së kontratës me Bashkinë, firma e re e pastrimit ka nisur punën në terren duke ndryshuar tërësisht panoramën që ishte deri pak ditë më parë. Ndërhyrja ka nisur me zëvendësimin e kontenierëve, duke vendosur kontenier të rinj në të gjithë territorin. Ndërkohë janë pastruar inertet dhe mbeturinat në zonat ku kishte probleme.

Drejtori i shërbimeve publike në Bashkinë e Lezhës, z. Ndue Lushi u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i hedhin mbeturinat e ndara në kontenier, ndërsa ka paralajmëruar të gjithë ata që nuk i hedhin inertet në vendin e caktuar nga Bashkia, se do të përballen me gjoba. Përfundimi i kontratës me ish-firmën e pastrimit krijoi një situatë problematike në Lezhë dhe Shëngjin, duke bërë që këto zona urbane, shpesh herë, të ngelin pa u pastruar. Gjithashu bashkia ka bërë të ditur se situata do të marrë zgjidhje shumë shpejt edhe në njësitë administrative ku aktualisht vërehen probleme.

Nisin përgatitjet për sezonin turistik



Bashkia Lezhë prej ditësh ka nisur punën në bregdetin e Shëngjinit, për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për sezonin e ri turistik. Me mjetet që disponon, Bashkia është duke ndërhyrë në pastrimin e rërës së plazheve, plugimin e shkriimitin e saj. Kjo procedurë po vazhdon edhe në plazhin e Tales. Vetë kreu i Bashkisë zoti Fran Frrokaj, po tregon kujdes e vëmendje për gjithë bregdetin e Lezhës dhe zonat e tjera turistike për të krijuar gjithë kushtet e nevojshme që pushuesit, vizitorët e turistët e huaj të kalojnë një sezon turistik të qetë dhe sa më komod. Pastrimi i mjediseve publike në bregdet, qytete dhe njësitë administrative, me kontraktimin e firmave të reja të pastrimit, po shkon drejt normalizimit të plotë.

Trajtimi i qenve të rrugës, prioritet

Me qëllimin kryesor, përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë publike po fillon të zbatohet një program gjithëpërfshirës dhe i provuar shkencërisht, me metoda të pranuar ndërkombëtare për të nxitur mbajtjen e përgjegjshme të qenve, në mënyrë që numri i qenve endacakë në territorin e Bashkisë Lezhë të zvogëlohet në mënyrë humane. Ky program zhvillohet në bashkëpunim me Organizatën “Jeta Tier Und Mensch” përfaqësuar nga Zj. Jenny Muller, veterineri Artenis Limoj dhe grupi i vullnetarëve “Help Animal Lezha” të cilët kanë ndërmarrë një fushatë për sterilizimin e qenve endacakë dhe rehabilitimin e tyre duke ngritur edhe një qendër të posaçme për sterilizimin e tyre. Në 6-mujorin e dytë të vitit të kaluar Bashkia Lezhë hartoi dhe zbatoi

Plan Veprimin për administrimin e qenve endacakë në qytet, plan i cili rezultoi efektiv. Por problemi i tyre i kalon kufijtë e kompetencave tona, për faktin se kujdesi dhe trajtimi i tyre kërkon kosto të lartë. Bashkia ka njoftuar edhe qytetarët që mbajnë qen të kenë kujdes në lidhje me trajtimin e tyre, në të kundërt sipas ligjit do të marrin masa ndëshkimore. Ndërsa njëra nga vullnetarët, Arta Uka, u shpreh se qytetarët duhet të sensibilizohen me këtë nismë, pasi një pjesë e mirë e qenve që qarkullojnë në qytet në fund të ditës kanë një pronar. Në momentin që privatët informohen, të merren me kafshët e tyre dhe të mos i hedhin në rrugë, t'i vaksinonjë dhe kështu numri reduktohet” tha Arta Uka, vullnetare. Deri tani janë kapur një numër i konsiderueshëm

qensh endacakë, ndërkohe që pas mjekimit, sterilizimit dhe më pas vaksinimit pritet që ata të mos përbëjnë më rrezik për komunitetin. Procesi do të fillojë me trajtimin e qenve nga ana e veterinerëve, pra kastrimin/sterilizimin, vaksinimin dhe mjekimin e tyre. Më pas do të fillojë faza e sensibilizimit rreth këtij programi me ndihmën e vullnetarëve, veterinerë, fëmijë dhe nxënës të shkollave për të diskutuar mbi tematika të ndryshme të lidhura me mirëqenien e kafshëve dhe raportit njeri-kafshë. Me anë të këtij programi synojmë të ndikojmë në përmirësimin e shëndetit publik dhe situatës së krijuar nga prania e qenve endacakë duke dhënë alternativa për trajtimin e tyre dhe duke promovuar shërbime të profesionalizuara për kafshët.



Koha për të kulluar tokat

GJOVALIN GJELOSHI

Në periudhën 10 mujore, 1 korrik 2016 - 30 prill 2017 në fushat e bashkisë së Lezhës janë pastruar 60 km kanale, kryesisht të dyta, kulluese, me një volum prej mbi 120 mijë metra kub dhera dhe me impakt në kullim në mbi 1500 ha tokë. Duket se po lëvizim sadopak në përmirësimin e kullimit të tokave bujqësore. Nevojat janë të ngutshme dhe ndërhyrjet duhet të shkojnë gati në kufinj të emergjencës, por mundësitë tona modeste janë shfrytëzuar në maksimum. Mbi 15 mijë ha tokë në bashkinë tonë kanë nevojë për pastrim të kanaleve si të dyta edhe të treta kulluese. Agjensia e kullimit në bashki, e krijuar vitin e kaluar me vendim të veçantë të KM, ka në dizpozicion një numër minimal të mjeteve dhe fondeve për të përballuar të gjithë këtë volum punimesh. Prej dy eskavatorëve me kapacitet të lartë që u bënë transferim nga Bordi i Kullimit (Ministria e bujqësisë), në pronësi të bashkisë, njëri prej tyre për difekte të rënda pothuaj të pariparueshme, nuk ka punuar

as 20 ditë të marra të gjitha së bashku gjatë kësaj periudhe 10-mujore. Eskavatori i dytë, i mbajtur mirë teknikisht, (megjithëse i vjetër), për meritë të manovratorëve me eksperiencë dhe të përkushtuar për punën, përjashtoi ditët që mjeti ka kryer shërbimet për difekte të ras-



tit apo riparime të planifikuara, ka kryer volumin më të madh të punimeve të përgjithshme të bëra gjatë kësaj periudhe. Në këta 10 muaj e në vazhdim, ky mjet po punon pa pushim në pastrimin e thellimin e kanaleve kulluese kryesisht të dyta, në fushën e ish kënetës së Kakarriqit. Në këtë zonë shtrihen fshatrat Balldre i Ri, Torovicë, Malecaj,

Koljakaj e pjesërisht edhe fshati Balldre i Vjetër.

Gjatë kësaj periudhe për të arritur në këto shifra punimesh, na kanë ardhur në ndihmë edhe dy eskavatorë të vegjël, pronë e ish komunave, të cilët i administrojnë Agjensia e Kullimit e Ujitjes në Bashki. Ardhja e një eskavatori të ri, megjithëse pas shumë muaj premtimesh prej qeverisë, i dha një impakt të ri ritmit të punimeve. Duhet thënë se i njëjti volum punimesh që është bërë vitin e kaluar për një periudhë 6-mujore, këtë vit u realizua në katër muaj.

Agjensia e Kullimit në përbërje të drejtorisë së bujqësisë, pyjeve e zhvillimit rural, ka bërë një studim të përgjithshëm dhe ka përcaktuar nevojat që kanë Njësitë Administrative në pastrimin e thellimin e kanaleve kulluese. Por nevojat janë njëra anë: ato janë të shumta në të gjithë sipërfaqen e tokave që disponojmë dhe të papërbalueshme për t'i kryer në kohën e duhur e kësajsoj të plotësohen kërkesat e fermerëve, të cilat në shumë raste bëhen me këmbëngulje. Ne, të gjendur përballë volumeve të

mëdha të punimeve në kullimin e tokave bujqësore, jemi përpjekur të bëjmë maksimizimin e renditjes së prioritetëve. Dy janë frontet prioritare që janë vlerësuar gjatë kësaj periudhe: Njësitë Administrative Balldre dhe ajo Zejmen. Me fjalë të tjera jemi përqëndruar në zonat ku shtrihen tokat me probleme më të mëdha për tepicën e lagështirës. "Kënetat e Kakarriqit", "Kënetat e Treshit apo Spitenit"

akoma nuk janë harruar në të folmen e banorëve të këtyre anëve. Ndaj edhe puna jonë këtu është përqëndruar. Nga 60 km kanale të thelluara, 31 km janë realizuar në Njësinë Administrative Balldre, kryesisht në ish-kënetë dhe 19 km janë thelluar e pastruar në Njësinë Administrative Zejmen, në fshatrat Spiten e Tresh, kryesisht. Pjesa e mbetur është realizuar në fshatin e Ishull-Shëngjinit. Ndërsa në

njësitë e tjera administrative janë bërë punime të papërfillshme që nuk e kalojnë gjatësinë e nga 0.6-1 km, si në Blinisht, Shënkoll apo Kolsh e Dajç.

Në muajt në vijim, përveç njësite ku janë kryer volumet kryesore të punimeve në kullim, do të përqëndrohemi në njësinë administrative të Shënkollit, të Blinishtit e Dajçit si dhe në Kallmet ku nuk kemi kryer asnjë ndërhyrje.



Frrokaj pret deputetin e CDU-së Thorsten Frei



Gjatë së dieles Kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj priti në një takim të ngrohtë deputetin e CDU-së Thorsten Frei, njëherazi Anëtar i Komisionit për Çeshtjet e Jashtme dhe raportues për Shqipërinë në Bundestagun gjerman si dhe z.Walter Glos, drejtor i KAS në Shqipëri. Raportuesi për Shqipërinë Thorsten Frei u ndal tek situatë aktuale në vend, nga ku deklaroi se situata politike aktuale kërkon zgjidhje gjithëpërfshirëse në dobi të demokracisë dhe mirëqenies së shqiptarëve. Si njohës i mirë i pushtetit lokal dhe si drejtues në vite i një bashkie në Gjermani, Frei u ndal te reforma territoriale në Shqipëri që sipas tij kjo reformë duhet me deomos të shoqërohet me shtim të kompetencave, ndërsa kritikoi edhe diferencimin që Qeveria Shqiptare bën në ndarjen e fondeve bashkive sipas përkatësive politike. Nga ana tjetër Frrokaj, përshendeti ndihmën dhe asistencën që Gjermania i ka dhënë vazhdimisht Shqipërisë, ndërsa vuri në dukje mundësitë e mëdha që Lezha i ofron për investime biznesit gjerman si në fushën e turizmit, bujqësisë, fasonëve etj.

Kreu i bashkisë Frrokaj i njohu po ashtu Frei dhe Glos me një panoramë të përgjithshme të Bashkisë Lezhë, ku vuri në pah se, pavarësisht diferencimit që Qeveria i bën kësaj bashkie dhe borxhit të trashëguar, përpjekjet janë të vazhdueshme për të rritur investimet dhe mirëqenien e qytetarëve.

Ambasadori Sjaastad, në Lezhë për detin



Ambasadori i Norvegjisë në Kosovë dhe Shqipëri, me seli në Prishtinë, Sh.T. Per Strand Sjaastad, ishte për vizitë në Lezhë, në kuadër të turit të tij për të vlerësuar mundësitë për bashkëpunim mes dy vendeve. Bashkëpunimi kryesisht në fushën e ujërave si dhe atë të marinës ishin në qendër të diskutimeve mes Ambasadorit të Norvegjisë, Per Strand Sjaastad dhe Kryetarit të Bashkisë së Lezhës Fran Frrokaj. Nga ana tjetër ambasadori norvegjez, Per Strand Sjaastad, u ndal edhe tek sistemi i taksave. Ai tha se, në Norvegji pushteti lokal mbledh pjesën dërmuese të taksave, ndryshe nga sa ndodh në Shqipëri, praktikë të cilën, shtoi se, Shqipëria duhet ta përqafojë. Me pas, Ambasadori Sjaastad zhvilloi një vizitë në bashkinë e Lezhës, ku u njoh nga afër me potencialet për tërheqjen e investimeve të huaja. I shoqëruar nga stafi i bashkisë, ai vizitoi biznese të ndryshme ku u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit, duke këmbyer eksperiencën që kanë norvegjezët në fushën e peshkimit me mundësitë e shumta që ofrojnë ujërat territoriale të Shqipërisë si dhe kapacitetet përpunuese të peshkut në rajonin e Lezhës. Këtij qëllimi i shërbeu edhe vizita në Portin e Shëngjinit ku drejtori i portit, z. Gjovalin Tushaj i shpjegoi kapacitetet aktuale, mundësitë dhe projektet e parashikuara për ndërhyrje si për rritje kapacitetesh ashtu edhe për shtim funksionesh. Ambasadori Sjaastad ishte i interesuar edhe për mundësitë për ngritjen e një kantieri për ndërtim e riparim anijesh pranë këtij porti, duke premtuar se do të diskutojë me bizneset norvegjeze për të krijuar mundësi të qarta bashkëpunimi.

Biznesi kroat, interes për investime në Lezhë

Ambasadorja e Kroacisë në Shqipëri, Sanja Bujas-Juraga zhvilloi sot një takim në Bashkinë e Lezhës, ku diskutoi për mundësitë e bashkëpunimit në disa fusha. Gjatë vizitës në Lezhë diplomatja kroate shoqërohej nga përfaqësues të biznesit si dhe deputetja shqiptare e parlamentit kroat, Ermina Lekaj Përlaskaj. Në fokus të takimit me kryetarin e bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj, ishte rritja e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona si dhe mundësitë për shtimin e prezencës kroate në Shqipëri, kryesisht për zonën bregdetare. Për ambasadorën Juraga, Lezha është një mundësi e mirë për të bashkëpunuar në fusha që për ta janë prioritare si agroturizëm, agroindustri, bujqësi dhe tregti. “Ne jemi dy popuj që mund të bashkëpunojmë ngushtë dhe të kemi marrëdhënie gjithnjë e më të konsoliduara mes nesh. Të dyja vendet tona kanë orientime të ngjashme, për të cilat mund të bashkëndajmë eksperiencën tonë si dhe të rrisin bashkëpunimet ndërmjet sektorëve respektivë. Lezha në veçanti përmbush më së miri pritshmëritë tona, ndaj edhe e kemi orientuar drejt Lezhës fokusin tonë për të rritur këtë bashkëpunim. Bujqësia, turizmi dhe kultura janë disa prej drejtimeve që besoj se prezantojnë edhe interesat e bizneseve të dy vendeve tona për të bashkëpunuar, ndaj edhe në vizitën time shoqërohem nga përfaqësues të biznesit, ndërsa kam në krah edhe mbrojtësen e interesave të dy vendeve tona siç është zonja Përlaskaj, që është edhe deputetja e parë shqiptare në parlamentin kroat”, tha ambasadorja kroate.

Kryebashkiaku Fran Frrokaj bëri një prezantim të përgjithshëm të qytetit dhe të Bashkisë Lezhë, duke theksuar zhvillimin e vrullshëm që ka pësuar sektori i



turizmit, kryesisht në zonën bregdetare të Shëngjinit. Gjithashtu, ai e ftoi ambasadorën kroate për të shtrirë bashkëpunimin dypalësh në shumë fusha, duke theksuar se kjo njësi vendore ka një pozicion strategjik përse i përket zhvillimit të aktivitetit privat, duke qenë një nyje lidhëse mes kryeqytetit dhe veriut të vendit, shumë pranë aeroportit të Rinasit dhe pranë aksit kryesor që lidhet me Kosovën dhe pjesën veriore të Gadishullit Ballkanik. Frrokaj e siguroi ambasadorën Juraga se stafi i bashkisë do të jetë në gatishmëri për të bashkëvepruar në interesin dypalësh, ndërsa nga ana tjetër, ftoi sektorin privat kroat që të jetë më i pranishëm në Lezhë.

Në takimin që ambasadorja kroate Sanja Bujas-Juraga zhvilloi me kreun e bashkisë Lezhë u ra dakort që bashkëpunimi të thellohet me hartimin e programeve të bashkëpunimit në disa fusha të ndryshme, si edhe u shfaq interesi i përbashkët për binjakëzimin e bashkisë Lezhë me bashkinë Zare në Kroaci, ku jeton edhe komuniteti më i madh shqiptar.

Shkëmbim eksperiencash me bletërritësit italianë

Në kuadër të Paktit të Miqësisë ndërmjet komunës Bra dhe Bashkisë Lezhë, është organizuar një takim mes bletërritësve ku janë shpalosur tematika për mënyrën e rritjes, kurimit dhe degustimit të mjaltit. Në këtë takim ishte prezent edhe Dario Pozzolo, drejtor i bujqësisë në komunën Bra (CN), Itali, një bletërritës profesionist. Takimi u zhvillua nga data 19 shkurt deri me 26 shkurt me pjesëmarrjen e 30 bletërritësve.

Pasi u njoh me mënyrat, teknikat që përdorin dhe vështirësitë që hasin bletërritësit në zonën e Lezhës, Pozzolo ka prezantuar mënyrën sesi trajton procesin e bletërritjes, duke na njohur me teknika të reja dhe frytdhënëse, si: furnizimi, prodhimi, punimet në laborator, trajtimi kimik dhe fizik, si dhe çfarë duhet bërë për të luftuar sëmundjet që kapin bletët. Ky prezantim shfaqti një interes shumë të lartë tek bletërritësit, interes që u shoqërua me diskutime të shumta. Në ditën e fundit diskutimi u përqëndrua mbi prodhimin final, mjaltin. U cilësuan karakteristikat e një prodhimi të shëndoshë dhe të pastër. Programi theksoi rëndësinë e një ushqimi cilësor dhe të shëndetshëm dhe një mënyrë për të ofruar një mjaltë cilësor dhe etiketimin që shërben për garanci për konsumatorin. U diskutua edhe mundësia për të eksportuar mjaltë drejt Europës, dhe për këtë duhet që cilësia të jetë e një standarti shumë të lartë. Më pas në një ambient të përshtatshëm dhe të këndshëm agroturizmi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave të bletërritësve në Shqipëri u zhvillua një degustim profesional i mjaltit që prodhohet në Shqipëri dhe të mjaltit që prodhohet në Itali. Pas degustimit, programi u konkretizua me një shëtitje në rrethinat e Bashkisë Lezhë për të parë më nga afër mënyrën e rritjes së bletëve dhe prodhimit të mjaltit.



Vizitë studimore në komunën Otmuchow, Poloni

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Lezhë dhe Komunës Otmuchow, rrethi Nysa në Poloni gjatë muaj Mars 2017 deri ne Prill 2017 një delegacion i Bashkisë Lezhë I përberë nga Arlinda Marku, Gjovalin Kaceli dhe Zerina Ivanaj moren pjesë në trajnimin dhe shkëmbimin e përvojave në kuadër të aplikimit në projektet e Bashkimit Europian.

Vizita konsiston në trajnimin e stafit në aplikimet në fondet e BE-se, ku ne fund te trajnimit ata u pajisen me certificate. Gjithashtu gjatë këtyre diteve ata kanë organizuar takime në rrethin Nysa, Bashkinë Nysa dhe në Komunën Otmuchow të cilat kanë si qëllim në vazhdimësinë e bashkëpunimit midis Bashkisë Lezhë dhe Komunës Otmuchow dhe gjithashtu me Rrethin Nysa.

Prezantimi me kryetarit të komunës Otmuchow dhe në ditët në vazhdim vizitë në secilen zyrë të komunës duke u prezantuar me funksionet dhe aktivitetet që ata merren cdo dite. Gjatë takimeve u diskutuan krijimi i një këndi dhe një guide të përbashkët, dhe aktivitete të përbashkëta që do sjellin vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi.

Gjithastu gjatë këtyre diteve u bë një vizitë në Qarkun Nysa, me kryetarin Czeslaw Bilobran dhe Dr. Promotionit dhe Turizmit Izabela Kicak ku u shkëmbyen ide për vazhdimin e bashkëpunimit dhe realizimin e disa aktiviteteve të përbashkëta midis bashkisë dhe qarkut si : Krijimin e një këndi të përbashkët midis Bashkisë Lezhë dhe qarkut Nysa. Botimin e një guide të përbashkët e cila është në anglisht dhe polonisht

ku promovohet vendet dhe vlerat turistike të secilës zone dhe që do jetë gati në muaj Maj. Promovimi I etnografisë dhe gastronomisë në zonen e Lezhës.

Takimi në Bashkinë Nysa u organizua gjatë javës së tretë : ku gjatë kësaj vizite kanë takuar:

Magdalena Ziolo: Përgjegjëse për Promovimin dhe Turizmin e cila prezantoi me mënyren se si ata promovojnë vlerat e vendit të tyre nepërmjet video-ve me pamje nga Nysa, pikave turistike si dhe të njerëzve që janë të sukseshëm, broshurave dhe krijimi I partneriteteve me vende të ndryshme.

Antol Bukala: Përgjegjës për Projektet me BE dhe Fondet Qeveritare. Aplikimit tek fondet e BE-së në thirrjet e ndryshme, aplikimet në fondet qeveritare.





Panairi i Turizmit Mesdhetar

GJERGJ FIGURI

Në Panairin Mesdhetar të Turizmit, organizuar për dy ditë me radhë në Tiranë, Bashkia Lezhë prezanton vlerat turistike dhe kulturore të sajë. Ndër të tjera Lezha promovon edhe mundësitë e eksplorimit të destinacioneve të reja turistike, që mund të ndikojnë në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve të huaj. Në stendat e pavionit të Lezhës u vunë re shumë vizitorë, të cilët shfaqën interes jo vetëm për bregdetin dhe plazhet mjaft të frekuentuara, por edhe për traditat kulturore, folkun burimor, instrumentet e kostumet popullore, gastronominë dhe historinë e lavdishme. Përmes këtij aktiviteti promovues synohet rritja e bashkëpunimit rajonal si dhe rritja e numrit të turistëve në Lezhë.

Panairi Mesdhetar i Turizmit, synon të jetë një pikë takimi e një rëndësie rajonale të aktorëve të industrisë turistike, siç janë operatorë turistikë, agjenci shtetërore, bashkitë, apo edhe organizata lokale e institucione ndërkombëtare.

“Duke filluar nga viti i kaluar ne jemi përpjekur ta shfaqim Shqipërinë në më shumë se 15 panaiare. Ka disa gjëra që duhen zbuluar në rajon, në vendin tonë, ndaj dhe tema e këtij panairi u vendos të quhej Mesdheu por edhe më shumë Shqipëria, si destinacion i rëndësishëm turistik”, deklaroi ministrja e Ekonomisë, Milva Ekonomi.

Turizmi është kthyer në një nga mbështetësit kryesorë të ekonomisë në vend. Edhe bashkitë po fokusohen në nxitjen e këtij sektori, i cili po gjeneron vende pune dhe po hap biznese të reja. Po ashtu, panairi ka si qëllim të përfshijë Shqipërinë në kalendarin ndërkombëtar të panaiareve të turizmit dhe udhëtimeve.

Festa e Pashkëve ne Lezhë



Besimtarët katolikë të Lezhës kanë kremtuar Ditën e Pashkëve, ngjalljen e Krishtit, si dita më e rëndësishme në kalendarin festiv të krishterë. Janë fëmijët e Qendrës Kulturore “Gjergj Laca”, të cilët duke zënë vend para Katedrales së Shën Nikollës dhe pranë bustit të Papa Gjon Palit të dytë kanë pritur besimtarët katolikë, kalimtarë të shumtë në rrugë dhe qytetarë të Lezhës duke u sevitur atyre vezë te kuqe dhe pije me lëngje frutash të përgatitura me dashuri dhe kujdes nga lokalet “Mrizi i Zanave” dhe “Stela”. Drejtori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve Marçel Laca, një ndër gjeneratë kryesorë të kësaj ditë-feste, me entuziazëm e dashuri citon vargjet e poetit

tonë kombëtar At Gjergj Fishta: “Kemi Bajram e kemi Pashkë dhe Shqipërinë e kemi bashkë” E veçanta e festimit të Pashkëve këtë vit ishte një shportë e stërmadhe me 1984 kokrra vezë, simbolikë kjo e viteve kur është ringjallur Jezu Krishti. Pronari i Mrizit të Zanave Altin Prenga e ka përgatitur enkas për këtë Ditë, si dhuratë për bashkëqytetarët e tij. Lirim Torba, pronari i lokalit “Stela”, edhe ky, është treguar mjaft bujarë në këtë Ditë të Pashkëve me fëmijët e qytetit dhe vëllezërit e besimit katolik. Të gjithë besimtarët shkëmbyen urime me njëri-tjetrin për këtë ditë, duke u lutur për më shumë besim, dashuri, paqe, begati dhe lumturi.

Më pas në Katedralën e Shën Nikollës ipeshkvi i dioqezës së Lezhës Otavio Vitale celebron meshën e shenjtë. Ai tha para besimtarëve që duhet besim i madh në Zotin Jezu Krisht, reflektim për të dhuruar sa më shumë dashuri për njëritjetrin. Dita e Pashkëve si ditë e shenjtë e ringjalljes së Krishtit, si ditë e ringjalljes së shpirtit njerzor dhe besimit tek Zoti, qoftë e lumtur për të gjithë! Flaka e ndezur simbolizon Ringjalljen e Krishtit pas sakrificimit të tij në kryq, moment ky që simbolizon rilindjen e shpresës, forcimin e besimit tek Zoti për të gjithë besimtarët, kalimin nga e përkohshmja në të përjetshmen dhe çlirimin e njerëzve nga mëkati.

Lezha mirëpret arbëreshët

Kanë mbërritur ne qytetin historik të Lezhës një grup vizitorësh nga Italia i përbërë nga 50 arbëreshë të katundeve Frashineto, Ejanina, Civita dhe San Marzano. Kjo vizitë realizohet në përkujtim të 550-vjetorit të betejës së fundit të Gjergj Kastriotit, e cila me 24 prill 1467, në Krujën legjendare, u kurorëzua me fitore. Bashkia Lezhë e përkrahu dhe mbështeti financiarisht këtë veprimtari mbarëkombëtare të inkuadruar në nismën: “Foleja Kombëtare Shqiptare”. Vizitorët arbëresh, shoqëroheshin nga përgjegjësi i trashëgimisë kulturore Paulin Zefi, drejtori i Turizmit Ardian Laçi, drejtori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve Marçel Lacaj dhe pasardhësi i familjes së Skenderbeut Loris Kastriot. Pas vizitës në Krujë, ata ndaluan fillimisht tek Obelisku i Kuvendit Historik të Lezhës, i cili daton një ndër ngjarjet më kulmore në historinë e kombit shqiptar. Në shesh vëllezërit arbëresh u pritën nga kreu i Bashkisë së Lezhës z.Fran Frrokaj, i cili duke ju uruar mireseardhjen i ftoi në mjediset e institucionit që drejton. Në fjalën e tij përshëndetëse kreu i Bashkisë zoti Frrokaj theksoi se, -“Ne jemi krenar që identifikohemi me prijesin e Kuvendit të Lezhës, Gjergj Kastriot Skenderbeun, këtë kalorës legjendar që për 25-vjet mbrojtje atdheun e tij dhe u bë mburojë e qyteterimit europian. Më pas përshëndetën dhe kryetarët arbëresh të Bashkive, Noe Andreano dhe Antonio Caprino shprehën optimizëm për vijueshmërinë e veprimtarive të tilla, që garantojnë partneritet të vazhdueshëm me Bashkinë e Lezhës.

Më pas aktorë dhe grupe artistike të Lezhës dhe delegacionit arbëresh dhanë një koncert të përbashkët me krijime e këngë kushtuar Gjergj Kastriot Skenderbeut. Nga Lezha delegacioni arbëresh do të vizitojë Shkodrën dhe qytete të tjera shqiptare.



Konkursi i ideve më të mira të biznesit

Shkolla e mesme profesionale “Kolin Gjoka” në Lezhë ka organizuar konkursin për idenë më të mirë të biznesit. Në përzgjedhjen e pesë grupeve konkurruese drejtorja e shkollës dhe mësuesit specialist të sajë po punojnë prej javësh me grupe nxënësish. Siç bënë të ditur drejtori Bardh Dedgjonaj këto pesë ide të paraqitura para një jurie të përbërë nga biznesmen, specialist të kurinarisë, turizmit, ekonomisë dhe zanateve të tjera vlerësuan idetë më të mira duke përzgjedhur dhe fituesit, të cilët do të kenë mbështetje të vazhdueshme deri në ngritjen e bizneseve të reja. Kjo shkollë është vendi ku konkretizohet teoria me praktikën dhe përgatitën specialist të kualifikuar për nevojat që ka aktualisht tregu i punës. Drejtori i turizmit, arsimit dhe kulturës pranë Bashisë Lezhe Ardian Laçi vlerësoi punën e shkollës profesionale “Kolin Gjoka” në ndërmarrjen e këtyre ideve mjaft të dobishme në përfeksionimin e zanateve dhe zhvillimin e biznesit, turizmit e ekonomisë në tërësi. Pas argumentimeve teorike dhe demonstrimeve praktike të nxënësve juria shpalli si ide fituese grumbullimin dhe përpunimin artizanal të guackave të detit dhe modifikimin e mobiljeve të përdorura. Nërkohë me çmim inkurajues u vlerësua ideja e prodhimit të makaronave dietike. Këto ide fituese,veç biznesit vendas, do të mbështetën edhe nga shoqata zvicerane Swiss Kontakt, e cila po ndihmon me trajnime nxënësish dhe kompletimin e klasave të kësaj shkolle të re me paisje bashkëkohore dhe laboratorë mësimor.



Rrugëtimi i Bibliotekës ...

SUELA BALA

Biblioteka e Lezhës u krijua si një sallë modeste leximi brenda ambienteve të ish shtëpisë së kulturës të qytetit të Lezhës. Me 1962 biblioteka me një fond prej 1200 librash, kaloi në katin e dytë të ish kinema "Drinit". Në këtë kohë u hap edhe reparti i të vegjëlve. Për nevoja zgjerimi, më 1976 si bibliotekë u përdor një ndërtesë njëkatëshe në bregun e "Drinit". Në atë kohë, librat në gjuhë sllave zin pjesën më të madhe të fondeve. Në vitet '90 biblioteka arriti në 65.000 ekzemplarë, libra e dokumenta me rreth 15.000 tituj. Biblioteka aktuale e qytetit të Lezhës përfundoi në qershorin e vitit 2001, ndërsa punimet për ndërtimin e saj kishin filluar që me 1988. Ajo ndodhet në Sheshin historik të qytetit, në krah të Memorialit të Skënderbeut.

Pak histori...



Historia e bibliotekave është e pandarë nga lashtësia e gjuhës dhe e kulturës së popullit shqiptar. Krahas të dhënave për historinë, zbulimet arkeologjike dëshmojnë për ekzistencën edhe të bibliotekave. Lissus-i antik mendohet të jetë njëra prej qendrave të hershme të depozitimit të dokumentave, krahas Durrësit, Beratit, Finiqit e Apollonisë. Fillimet e botimeve të para në gjuhën shqipe në shek.16-të edhe në rrethinat e Lezhës, përkohë me hapjen e shkollave si ajo e Blinishtit e Pllanës në vitet 1638. Pjetër Bogdani në veprën "Çeta e Profetëve", shkruan për përpjekjet e ungjit të tij për ngritjen e bibliotekës dhe ruajtjen e librave të saj. Sipas të dhënave, bibliotekat e para në trevat e Lezhës i përkasin shek.19-të e fillimit të shek.20-të. Ato gjëndeshin kryesisht pranë institucioneve fetare, apo ishin përkatesi e përsoneve kulturdashës. Fondi i tyre, sado të



ketë genë, pasqyron nivelin intelektual të kohës, prirjet dhe dëshirat e hershme, përpjekjet për kulturë e dije. Shënime të kohës dëshmojnë për bibliotekën e Shkodrës, e krijuar në fundin e shek 19-të prej myftiut të njohur të Tabakëve. Ajo ishte e pasur me dorëshkrime në shqip, të shkruara në alfabetin turk me mbi 2000 vëllime me përmbajtje teologjike, filozofike e juridike në gjuhët arabe, perse e turke. Kolegji i Troshanit në rrethin e Lezhës u hap më 14 qershor 1882 prej padër Marian Pizzochini prej Palmonovet dhe padër Gjon Pjerino prej Bergamos. Aty pati një bibliotekë të cilën e shfrytëzuan jo vetëm pedagogët dhe meshtarët, por edhe ish nxënësit e këtij kolegji si Fish-ta, Gjeçovi etj. Kolegji në një kohë ishte qendër Noviciate. Aty janë dhënë lëndë filozofike e teologjike të nivelit të lartë. Biblioteka e Troshanit qëndroi si e tillë deri në vitin 1967. Sappa apo Zadrime e sotme ku ka shërbyer Frang Bardhi, autor i të parit fjalor të gjuhës shqipe dhe i shumë relacioneve, përligj arsytimin që

aty të ketë patur edhe një bibliotekë. Përmendim këtu faktin se kur Bardhi u ul për të shkruar "Apologjinë e Skënderbeut", na thotë se iu desh të konsultohej me gati 120 shkrime, libra e autorë botuar asokohe rreth heroit tonë të madh. Përmendet edhe biblioteka e Gaspër Gurakuqit, etnograf, studiues i historisë, për shumë vjet meshtar në famullinë e Dajçit të Zadrimës. Biblioteka i përket fillimeve të shek. 19-të. Pati mbi 1500 ekzemplarë librash fetarë dhe për qëllime mësimore. Biblioteka qëndroi deri në vitin 1967. Një pjesë e këtij fondi ruhet sot në Bibliotekën publike të Lezhës.

Biblioteka sot...

Aktualisht biblioteka ka 4 salla leximi me një kapacitet ulës prej 250 vendesh të njëkohshëm dhe konkretisht: Salla e librit shqip dhe të përkthyer, Salla e albanologjisë, Salla e librit në gjuhë të huaj dhe Salla e fëmijëve. Veç këtyre, në shërbim të lexuesve e përdoruesve është hollu në katin e dytë, ku shërbehet shtypi korent,



hapen ekspozita e panaire libri dhe zhvillohen veprimtari bibliotekare e kulturore.

Biblioteka disponon një fond prej rreth 100.000 ekzemplarësh me mbi 25.000 tituj. Në shërbim të përdoruesve ka libra e përkthime artistike në shqip e gjuhë të huaja, si dhe një fond prej rreth 7000 ekzemplarësh të periodikut, kryesisht të periudhës 1958 e këtej. Por fondet e bibliotekës ruajnë edhe një numër revistash e dokumentesh që i përkasin gjysmës së parë të shek. 20, koleksione të revistave tashmë të njohura si “Hylli I Dritës”, “Leka”, “Zani i shna Ndout”, “Lajmëtari i zemrës së Jezu Krishtit” etj. Përmendim një fond tashmë të rrallë, libra e dokumente prej 1100 ekzemplarësh, kryesisht të literaturës religjioze në gjuhët latinisht, italisht e turqisht etj, që u përkasin botimeve të periudhës para vitit 1830.

Fondet ndarë sipas tematikës janë:

1-Libra shqip e të përkthyer - 19130 tituj me 72728 ekzemplarë.

2-Libri i huaj - 6620 tituj me 7000 ekzemplarë.

3-Albanaologji- 1020 tituj me 6294 ekzemplarë.

4-Atikuarë 74

5-Libra për fëmijë-1989 tituj me 16511 ekzemplarë.

6-Periodiku në shqip-58 tituj me 5100 ekzemplarë.

7-Periodiku i huaj- 34 tituj me 1920 ekzemplarë.

I gjithë fondi është i sistemuar e i përpunuar sipas standarteve të reja, ndërsa shërbehet me fond të hapur. Koleksionet janë renditur sipas fushave të dijes. Lexuesi paraqitet pranë autorit a rubrikës që dëshiron, e merr vetë librin a dokumentin dhe sipas nevojës e huazon për përdorim të përkohshëm në shtëpi. Biblioteka organizon aktivitete si: promovimet e librave, diskutimet krijuese e veprimtaritë me të rinj

të shkollave të mesme e të sistemit 9-vjeçar, ciklet e bisedave për letërsinë, veprimtaritë me shkrimtarë dhe krijues. Tashmë në disa prej këtyre veprimtarive është krijuar një përvojë si ato për “Ditën botërore të librit”, “Ditën e poezisë”,veprimtaritë për “Muajin e letërsisë” etj. Po kështu interesante janë ekspozitat e librit e etnografisë, ekspozitat e pikturës e të fotografisë, të cilat kanë ngjallur interes dhe janë mirëpritur. Biblioteka ka aktualisht 8 punonjës, 5 prej të cilëve me arsim të lartë, specializuar për bibliotekonomi. Stafi është me përvojë, me dëshirë e pasion për punën.

Biblioteka u shërben banorëve të Qarkut të Lezhës me një popullatë prej 220 mijë banorësh. Biblioteka është në shërbim të lexuesve në të gjitha ditët e javës: nga e hëna në të premte prej orës 8.00-17.00 ; të shtunave ajo gjëndet hapur prej orës 8.00-12.00 .

Folklori i Lezhës mirepritet ne Itali

Për tetë ditë rrjesht, u mbajt në Agrigento të Italisë, edicioni i 73-të i “Almond Blossom Festival”, ku pas 25 vitesh mori pjesë një grup artistik nga Lezha. Kjo mundësi përfaqësimi e Shqipërisë në këtë eveniment prestigjioz botëror u mundësua falë bashkëpunimit të Bashkisë Lezhë me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, drejtuar nga z. Agron Haxhimali. 29 instrumentistë popullorë, muzikantë, këngëtarë evallëtar nga veriu dhe jugu i vendit, performuan në skenat e këtij festivali, duke shfaqur vlerat dhe pasurinë e jashtëzakonshme të folklorit dhe kostumeve shqiptare. Interpretimet e pjesmarrësve nga Lezha morën vlerësime dhe duartrokitje të shumta krahas 13 shteteve të tjera pjesmarrëse.



IP Robot nga Lezha fiton kupën e Shkollave Profesionale



Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka" ka fituar kupën e Elektroteknikës në Panairin të Shkollave Profesionale "Olimpiada e Aftësisë" mbajtur në datat 27-29 Prill në Expo City, Tiranë. Ky aktivitet 3 ditor, krahas promovimit të shkollave të Arsimit Profesional, kishtë qëllim të krijojë hapësira të reja dhe bashkëpunim ndërmjet shkollave dhe aktorëve të sektorit të biznesit.

Ndër të tjera, Shkolla Profesionale e qytetit të Lezhës "Kolin Gjoka" mori pjesë edhe në sektorin Elektroteknikë (instalime civile dhe industriale), me robotin IP Robot të ndërtuar në laboratorët e shkollës. Roboti ndjek vijën e bardhë nëpërmjet sensorëve dhe gjithashtu bën filmim, foto, gjen vendodhjet, dëgjon dhe njuh zërat. Të gjitha këto komanda i jepen nëpërmjet një telefoni smart. IP Robot u ndërtua nga nxënësit Përparim Celami nga Lezha, Artilda Laska nga Mirdita, Drilon Pjetri nga Zejmeni dhe Martin Haxhia nga Rrila

në bashkëpunim me mësuesin e TIK, Jetmir Shtjefni. Gjithashtu, për ndërtimin e robotit u mor asistencë edhe nga ekspertë në Tiranë. IP Robot u përfundua me 21 prill, në kohë për të marrë pjesë në Panairin e Shkollave Profesionale. Falë punës së bërë dhe konkurimit dinjitoz në detyrën e dhënë IP Robot dhe nxënësit fituan kupën e eventit. Gjatë gjithë kohës administrata e shkollës "Kolin Gjoka" kanë qenë një suport i madh që nxënësve t'u krijoheshin lehtësirat e nevojshme, duke punuar edhe pas mësimit kur ka qenë e nevojshme. Shkolla aktualisht ka dy kabi-



nete TIK me paisje të fundit që mundësojnë realizimin e detyrave të tilla. Shumë shpejt pritet të vijë edhe një laborator i ri që do jetë në funksion vetëm për detyra të tilla mësimore. Duhet të theksojmë se nxënësit e kësaj shkolle kanë realizuar edhe një detyrë të re që është një makinë elektronike që ndjek dritën nëpërmjet sensorëve dhe gjithashtu po mendojnë me entuziazëm të bëjnë një projekt smart home (shtëpi inteligjente) ku çdo komandë t'ia japin shtëpisë me telefon. Shkolla "Kolin Gjoka" ka marrë një mbështetje të madhe nga projekti S4J i financuar nga Qeveria zvicerane, që po i ndihmon shumë në realizimin e projekteve të tilla duke u mundësuar laboratorët dhe ajsjet e tjera teknike.

Kampionati i peshkimit sportiv në Tale

Të apasionuarit pas peshkimit do të kenë mundësi që të testojnë aftësitë e tyre në një kampionat kombëtar. Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv ka hapur në Tale të Lezhës etapën e parë të kampionatit sportiv të peshkimit. 58 pjesëmarrës i janë bashkangjitur aktivitetit që organizohet për herë të parë. Peshkimi në det të trazuar mbajti për 4 orë mbërthyer të gjithë garuesit këtë fundjavë. Presidenti i Federatës Shqiptare së Peshkimit Sportiv, Vasjan Lami tha se edhe përzgjedhja e bregdetit të Tales nuk ishte e rastësishme. apësira e madhe e këtij bregdeti është një mundësi që ky sport të ushtrohet masivisht dhe me lehtësi, ndërsa është një sfidë edhe për të gjithë garuesit. Në startin e këtij kampionati ishte edhe kreu i bashkisë Lezhë, Fran Frrokaj. Ai u shpreh se e ka mirëpritur zgjedhjen që Federata Shqiptare e Peshkimit Sportiv ka bërë duke e nisur në Tale etapën e parë të këtij kampionati. Frrokaj shtoi se do të bashkëpunojë me këtë federatë në mënyrë që sportistët edhe të relaksohen duke ushtruar këtë sport, por ndërkohë edhe promovohen vlerat turistike që kanë zona të tilla siç është bregdeti i Tales. Garuesit i janë bashkuar këtij sporti më shumë si çlodhje, por ka edhe nga ata që e kanë pasion të trashëguar. Një pjesë e tyre tenton të dalë nga rutina e përditshme dhe peshkimi është një mundësi për tu relaksuar. Etapa e dytë e këtij kampionati do të vijojë me peshkimin në Shqipërinë e mesme për të vijuar më pas drejt jugut, kjo edhe si një formë gjithpërfshirëse për të promovuar sportin dhe turizmin. Organizatorët u kanë bërë apel të apasionuarve për t'iu bashkuar Kampionatit në fazat në vijim duke e lënë të hapur mundësinë për ata që munguan në çeljen e tij.



Sporti, aktivitetet komunitare në Lezhë

Bashkia e Lezhës i ka kushtuar një vëmendje të madhe zhvillimit të sportit dhe ruajtjes së kësaj discipline që ka nxjerrë sportistë të njohur ndër vite. Sektori i Sportit pranë Drejtorisë së Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka zhvilluar një sërë aktivitetesh të cilat janë promovuar si një qëllim në vetvete për të ruajtur këtë traditë dhe për ta bërë sa më përfaqësuese Lezhën në garat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Lezha dhe pse një qytet i vogël por me një traditë të fortë në futboll, nuk i kane munguar futbolistët që kanë bërë emer jo vetëm te ekipi i Besëlidhjes por edhe për kombetaren dhe në ekipe prestigjioze jashtë vendi. Kjo ka bërë që interesi të jetë gjithnjë në rritje dhe gjithnjë me shumë të rinj që të angazhohen në këtë sport. Ndër-

kohë përkrah klubit "Besëlidhja" janë hapur edhe dy akademi të futbollit si "Porto" dhe "Brians" të cilat kanë arritur rezultate të mira duke spikatur edhe talente të rinj të cilët falë këtyre akademive kanë arritur të bëhen pjesë e ekipeve më të mira shqiptare si Vllaznia e Partizani. Krahas futbollit, sektori i sportit i ka kushtuar vëmendje lojrave sportive me përfshirjen e grupeve të cilat kërkojnë mbështetjen e gjithë shoqërisë. Nën nismën "Luaj dhe unë", katër specialistët e sportit pranë Bashkise Lezhë kanë arritur të realizojnë disa aktivitete sportive me shoqata të ndryshme si: Shoqata e të Verberve, Fëmijet me sindromën Down, Qendra e Zhvillimit Ditor "Trendafilat", Komuniteti Rom & Egjiptian etj. Në "Ditët e lojrave Olimpikë" e konceptuar me lojra popullore e

sportive në shkollat dhe kopshtet e qytetit, sektori i sportit planifikoi një sërë aktivitetesh me përfshirje të gjerë edhe të shumtë qytetare, aktivitete të cilat janë organizuar në zona malore dhe ato bregdetare si dhe në pikat turistike të Lezhës. Bashkia e Lezhës ka hapur dyert e ambienteve sportive në shkollat komunitare ku këto terrene mbas-diteve kanë qënë në dispozicionin e qytetarëve duke organizuar ndeshje volejboli e basketboli. Një tjetër aktivitet i vecantë sportiv por me karakter mirënjohje ka qënë në kuader të shenjtërimit të "Nënë Terezes". Me "Maratona e Paqes" një rrugëtim me bicikletë nga qendra e qytetit deri pranë Hotelit të Gjuetisë u përcollën mesazhe paqeje, dashurie dhe mirënjohje, të cilat shpesh herë arrihen përmes sportit.



Njoftim për kontrollin e praktikës



Bashkia Lezhe në kuader të detyrimeve të ligjit 119/2014 "Per te drejten e informimit" ju rikujton te gjithë banoret e saj se per cdo kerkese apo ankese qe bejne prane Sporteve te Integruara te Zyreve me Nje Ndalese ne Bashkine Lezhe, Njesite Administrative Shengjin, Shenkoll, Kallmet dhe Balldre qe pas cdo kerkese apo ankese te pajisen me vertetimin qe u regjistruar kerkesa/ankese, vertetim qe permban kodin e praktikës. Me anen e ketij kodi ata mund te verifikojne statusin e kerkeses/ankeses se tyre ne faqen zyrtare te Bashkise Lezhe, ne seksionin Kontrolllo Praktiken Tuaj, ne anen e djathte te faqes. Per cdo mos kthim ne kohe te pergjigjes nga stafi i Bashkise Lezhe me ane te vertetimit me kodin e praktikës na ndihmoni per te gjurmuar personat pergjegjes nga stafi i Bashkise Lezhe por mos kthimin e pergjigjes dhe per marrjen e masave ndaj tyre si dhe kthimin e pergjigjes ndaj jush. Gjithashtu per te gjithë personat te cilet e kane te pamundur te paraqiten prane sporteve tona, mund te dergojne kerkesat/ankesat e tyre ne emailin zyrtar te Bashkise Lezhes info@lezha.gov.al apo posten zyrtare dhe kerkesat/ankesat tuaja do te merren parasysh me prioritetin me te larte.

Njoftim mbi e-pjesmarrje e qytetareve

Bashkia Lezhe eshte nje nga bashkite promotore te transparences ndaj qytetareve dhe e-pjesmarrjes se tyre ne vendimmarrje kjo e vleresuar nga sondazhe te ndryshme qe jane realizuar ne nivel kombetar ku Bashkine Lezhe e nxjerrin ne nivelet me te larta te transparences. Ne kuader ruajtjes se e-pjesmarrjes se qytetareve dhe transparences ne nivele te larta, si dhe permbushjes se detyrimeve qe vijne nga Ligji 119/2014 "Per te drejten e Informimit", Bashkia Lezhe fton qytetaret te behet pjeses e vendimmarrjes nepermjet seksionit e-pjesmarrja apo aksesimit te dokumentave te ndryshem strategjik te Bashkise, publikimeve tek Menuja Media dhe vendimeve te Keshillit tek faqja kryesore ose Menuja Bashkia per te cilet mund te japi mendim nepermjet emailit zyrtar te Bashkise Lezhe, info@lezha.gov.al



http://lezha.gov.al/web/Njoftim_mbi_e_pjesmarrje_e_qytetareve_1092_1.php#.WQhG_VV96M8

